



Edicioni i VII "Aulona International Folk Festival"

Vlorë, 7 - 9 maj 2015

Me ftesë të Qendrës Kulturore "AULONA", përfaqësues nga AMSHC merr pjesë në Edicionin VII të "Aulona International Folk Festival", i zhvilluar në qytetin e Vlorës.

Ky aktivitet është mbështetur financiarisht nga AMSHC në kuadër të Thirrjes Nr. 7 dhe Bashkia e Vlorës.



Takimi i shtatë i "Grupit Teknik të Punës" për një mjedis mundësues për shoqërinë civile në Shqipëri

Tiranë, 20 maj 2015

U zhvillua në Tiranë takimi i shtatë i "Grupit Teknik të Punës" për një mjedis mundësues për shoqërinë civile në Shqipëri.

Në këtë takim morën pjesë përfaqësues nga Kryeministria, Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Integritimit Evropian.

Në takim u diskutuan dhe u morën parasysh rekomandimet e propozuara nga ministritë e linjës si edhe nga OJF-të pjesëmarrëse

në takimet konsultative të zhvilluara nga "Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë" në bashkëpunim të ngushtë me "Agjencinë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile" në të gjithë vendin gjatë muajve mars dhe prill.

Njësia e Planifikimit Strategjik si njësi koordinuese së bashku me anëtarët e Grupit Teknik të Punës (GTP) shqyrtuan komentet në draftligjin "Për krijimin e Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile" të propozuara nga ministritë e linjës dhe grupet e interesit.

Shpallet Thirrja Nr. 8 për projekt-propozime

Tiranë, 1 qershor 2015

Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), në kuadrin e konkurimit të hapur dhe transparent sipas kriterëve të përcaktuara në Ligjin Nr. 10093, datë 09.03.2009 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile", në përputhje me statutin dhe misionin e saj: Asistencë Financiare për një zhvillim të qëndrueshëm të shoqërisë civile dhe krijimin e kushteve të favorshme për nisma qytetare në të mirë dhe interes të publikut; shpalli Thirrjen Nr. 8 për Shprehje Interesi për të gjitha OJF-të e interesuara për projekte.

Kjo thirrje për shprehje interesi kishte një natyrë stimuluese të fokusuar në organizatat e reja e veçanërisht për ato organizata të shoqërisë civile, të cilat do të operojnë në bashkëfinansim me të tjerë donatorë për arsye se kjo thirrje është e vogël referuar përmasave dhe buxhetit të akorduar për realizimin e saj.

Fokusi kryesor i Thirrjes Nr. 8 kishte fushat e mëposhtme:

1. Nixtja e zhvillimit lokal dhe rajonal, përmes përmirësimit të bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes, si dhe aktivizimit të aktorëve të zhvillimit dhe komunitetit;
2. Nismat mjedisore për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillim të qëndrueshëm;
3. Nixtja e zhvillimit komunitar, rritja e fuqizimit të vullnetarizmit si edhe bashkëpunimit lokal dhe rajonal, përmes promovimit të mundësive për të rinjtë, artit, kulturës, traditës etj.;
4. Zhvillimi i shoqërisë civile, përmes përmirësimit të instrumentave institucional, mekanizmave dhe mundësive;
5. Diaspora dhe emigracioni;
6. Promovimi i nismave të qeverisjes së mirë, përfshirë këtu luftën ndaj korrupsionit, zhvillimin e demokracisë dhe pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të qyterarëve në politikbërje;



Shoqëria Civile në Ballkan bën thirrje për më shumë përfshirje në procesin e antarësimit në BE

Beograd (Serbi), 2 - 3 Qershor 2015

Në Forumin e 5-të të Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor, i mbajtur në datat 2 dhe 3 qershor 2015 në Beograd, pjesëmarrësit pohuan se përkundër disa sfidave, perspektiva e antarësimit në BE do të ketë ndikim të rëndësishëm në Ballkanin Perëndimor. Kjo u theksua gjatë katër sesioneve tematike të diskutimeve me përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile (OSHC) nga Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Kosova, Mali i Zi, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Serbia.

Përfaqësues nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në këtë forum.

Partnerët socialë dhe organizatat e shoqërisë civile janë partnerë thelbësorë në përmirësimin e transparencës dhe gjithëpërfshirjes në procesin e antarësimit në BE.

Në këtë kuadër pjesëmarrësit i bënë thirrje qeverive dhe institucioneve të BE-së për të forcuar dialogun me OSHC-të dhe për të përmirësuar qasjen e informacioneve.

Korrupsioni - pengesa më e madhe për antarësimin në BE

Dobësitë e shtetit të së drejtës, si dhe korrupsioni, janë identifikuar si pengesat më të mëdha për antarësimin në BE. Pjesëmarrësit i bënë thirrje vendeve në rajon për të zbatuar rekomandimet kundër korrupsionit Grouped'Etatscontre la (GRECO), si hapi i parë për të luftuar korrupsionin. Zbatimi i standardeve për antarësim në aspektin e drejtësisë dhe sundimit të ligjit, si dhe mbrojtjen e lirisë së medias janë hapa të tjera të nevojshme.


Rritja e punësimit - një sfidë e përbashkët

BE-ja dhe Ballkani përballen me normat e larta të papunësisë, me të rinjtë dhe gratë veçanërisht të cilët vuajnë gjatë krizës së tanishme. Qeveritë dhe institucionet e BE-së do të duhet t'u japin prioritet mjeteve të nevojshme dhe kushteve për rritjen e punësimit. Pjesëmarrësit bënë thirrje për mbështetje të veçantë për të rinjtë dhe gratë.

Të drejtat e minoriteteve - forcimin e rolit të Avokatit të Popullit

Respektimi i të drejtave dhe lirive të lidhura me çështjet etnike, fetare, gjuhësore, gjinore, dhe orientimit seksual nuk është ende efektive në Ballkanin Perëndimor. Për të përmirësuar gjendjen e minoriteteve, pjesëmarrësit propozuan përforcimin e rolit të Avokatit të Popullit në vendet e rajonit, sipas modelit të Shqipërisë, dhe për të zbatuar në mënyrë efektive legjislacionin kundër diskriminimit.

Forumi i 5-të i Shoqërisë Civile të Ballkanit Perëndimor i mbylli punimet me miratimin e një deklaratë finale, e cila do t'i dërgohet autoriteteve kombëtare në rajon, Parlamentit Evropian, Këshillit Evropian dhe institucioneve të tjera.



Media dhe Marrëdhënia me Publikun për OSHC-të

Pogradec, 2 - 4 qershor 2015



Dy përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) morën pjesë në një trajnim tre ditor me temë "Media dhe Marrëdhënia me Publikun për OSHC-të", organizuar nga Zyra e TACSO Albania, në Pogradec.



Pjesëmarrësit theksuan se edhe pse ka një vetëdije në rritje rreth bashkëpunimit ndërmjet OSHC-ve dhe mediave, kjo nevojë për bashkëpunim ndërmjet tyre është ende e rëndësishme për të

siguruar vizibilitetin e veprimtarive të tyre, si dhe një qasje më të mirë me aktorët kryesorë që kontribuojnë në arritjen e misioneve të tyre.

Gjatë tri ditëve të trajnimit, përfaqësuesit e OSHC-ve diskutuan mbi mënyrat se si organizatat e sektorit të tretë duhet të përdorin median si një instrument i fuqishëm në mbështetje të fushatave të tyre advokuese dhe lobuese, apo duke evidentuar arritjet e tyre të mëdha për publikun.

Disa nga temat kryesore ishin:

- *Marrëdhëniet me publikun, rëndësia e marrëdhënieve me publikun për një organizatë;*
- *Zhvillimi i një strategjie komunikimi dhe strategjitë plotësuese për një OSHC;*
- *Mjetet e komunikimit, përgatitjen e deklaratave për shtyp, konferencave për shtyp, transmetimet, gazetatat, raportet vjetore;*
- *Teknikat e komunikimit, mediat dhe intervistat televizive;*
- *Menaxhimi i krizave dhe komunikimi gjatë krizës;*
- *Media sociale, Facebook, Twitter, Instagram, LinkedIn, Pininterets, YouTube, përdorimi i medias sociale për realizimin e qëllimeve të organizatës;*

Gjatë trajnimit u sqaruan gjithashtu, edhe disa vështirësi me të cilat përballen OSHC-të gjatë punës së tyre të përditshme, që kanë të bëjnë kryesisht me përgatitjen e mjeteve të komunikimit si (komunikata për shtyp, konferencat për shtyp, material për gazetë etj) dhe se si të përdorin në mënyrë efektive teknikat e komunikimit.



E veçanta e këtij trajnimi ishte intervistimi i të gjithë pjesëmarrësve në prezencën e kamerës televizive, ku të intervistuarit iu përgjigjen pyetjeve të gazetares duke prezantuar kështu arritjet e organizatave të tyre si dhe menaxhuan me sukses emocionet që të shkakton prania e kamerës.



U theksua gjithashtu, se mediat sociale paraqesin për OSHC-të një sfidë tjetër nëpërmjet së cilës mund të dërgojnë, në mënyrë efektive, mesazhin e tyre për të gjithë publikun.





AMSHC organizon trajnim me temë: "Për një Raportim të Suksesshëm Përshkrues dhe Financiar"

Tiranë, 4 qershor 2015



Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) organizoi në Hotel "Mondial" trajnimin e OJF-ve, me temë "Për një Raportim të Suksesshëm Përshkrues dhe Financiar". Qëllimi i këtij trajnimi ishte pikërisht ofrimi i asistencës së duhur teknike për të gjitha organizatat të cilat janë shpallur fituese në Thirrjen 7 për Projekt-Propozime; lidhur me të gjitha proceduarat e monitorimit dhe kontrollit si nga pikëpamja e realizimit të aktiviteteve ashtu edhe korrektësisë financiare.



Përfaqësueset e AMSHC-së znj. Hasa dhe znj. Lameborshi udhëzuan organizatat jo-fitimprurëse në mënyrë të detajuar çdo hallkë lidhur me kontrollin si edhe plotësimin e raporteve përshkruese dhe financiare për efekt monitorimi të projekteve të financuara me grante nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile.

Ky trajnim, i cili ishte i pari në llojin e tij do të vazhdojë të aplikohet edhe në thirrjet e radhës që do të zhvillojë AMSHC-ja.

Konferenca: "Kulturalisht të ndryshëm ... ndryshe në aftësi - Qasja në të drejta, shërbime dhe anti-diskriminim - Perspektiva e aftësisë së kufizuar"

Tiranë, 11 - 12 qershor 2015



Më datat 11 dhe 12 qershor 2015, në Hotel "Tirana International", dy përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile morën pjesë në një konferencë të organizuar nga Zyra e Projektit TACSO, Shqipëri.

Në këtë konferencë morën pjesë gjithashtu, përfaqësues të qeverisë konkretisht znj. Nora Malaj, Zëvendës Ministre e Arsimit dhe Sportit, znj. Bardhylka Kospiri, Zëvendës Ministre e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, një përfaqësues nga zyra e BE-së në Tiranë si dhe përfaqësues të organizatave dhe qendrave të shoqërisë civile nga Shqipëria, Kosova, Mali i Zi, Maqedonia, Bosnja dhe Herzegovina.

Kjo konference u hap nga z. Genci Pasko, Resident Adviser pranë TACSO Albania, i cili theksoi se konferenca ka për qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e OSHC-ve që mbështesin personat me aftësi të kufizuara, bazuar në standardet ndërkombëtare të BE-së, kryesisht lidhur me anti-diskriminimin, qasja ndaj të drejtave të tyre si dhe shërbimeve sociale. Ajo synon, gjithashtu, të kontribuojë në drejtim të përmirësimit të politikave të qeverive për të siguruar akses të personave me aftësi të kufizuara në institucionet publike arsimore / kulturore dhe të tjera.

Përfaqësuesit nga secili prej vendeve prezantuan përvojat e tyre të bazuara në aktivitetet dhe perspektivën e institucioneve të cilat ata përfaqësonin si dhe shqetësimet e OSHC-ve të tyre.

Pjesëmarrësit në konferencë bënë shkëmbimin e përvojave ndërmjet OSHC-ve që kanë si objekt të punës së tyre personat me aftësi të kufizuara, kryesisht të verbër dhe të shurdhër nga Shqipëria dhe rajoni, duke u fokusuar në ndërtimin dhe zbatimin e një politike arsimore gjithë përfshirëse si dhe krijimin dhe nxitjen e një klime kundër diskriminimit të tyre në vendet e Ballkanit Perëndimor.

Konferenca u konsiderua si një vazhdim i "Konferencës së përbashkët për të Drejtat Themelore, mos-diskriminimit dhe mbrojtjes së grupeve të rrezikuara, përfshirë LGBTI" të mbajtur në Tiranë, në nëntorin e kaluar.

Takimi është një mbështetje edhe ndaj konsultimit në internet, pjesë e projektit P2P, ku të drejtat themelore, veçanërisht të drejtat e grupeve vunerabël, kundër diskriminimit, si dhe aksesit në arsim / shërbime, konsiderohen si disa nga temat më interesante të propozuara nga OSHC-të.

Dita e dytë e këtij takimi u mbyll me një sërë aktiviteteve të organizuara nga Instituti i të Verbërve në Tiranë si dhe një vizitë në Kalanë e Krutës.



AMSHC merr pjesë në workshop me temë:

"Punëtori për Finalizimin e Rregullores për Subvencionimin e projekteve që promovojnë riintegrimin në RKS"

Durrës, 22 qershor 2015



Dy përfaqësues të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC), Znj. Leonida Hasa, Përgjegjëse e Sektorit të Financës dhe Kontrollit të Brendshëm dhe Z. Ferhat Aga, Specialist në Sektorin e Administrimit të Programeve të Granteve dhe Zhvillimit Rajonal, morën pjesë në një workshop të organizuar në Durrës nga Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Kosovës me titull: *"Punëtori për Finalizimin e Rregullores për Subvencionimin e projekteve që promovojnë riintegrimin në RKS"*.

Qëllimi i këtij workshop-i ishte njohja konkrete me procedurat e financimit me grante dhe mënyrën e funksionimit të Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile (AMSHC) duke nisur nga shpallja e

thirrjes për projekt-propozime deri në finalizimin dhe shpalljen e fituesve si dhe ndjekjen e projekteve të financuara deri në fund të realizimit të tyre nëpërmjet procesit të Monitorim/Vlerësimit.

Ky workshop vijoi në Durrës, në datat 22 - 26 qershor 2015 dhe konkludoi me finalizimin e Rregullores për Subvencionimin e projekteve që promovojnë riintegrimin në RKS, duke u konsideruar gjithashtu një pikë nisje e mbarë bashkëpunimi dhe shkëmbimi eksperiencash mes AMSHC-së dhe Departamentit të Riintegrimit të Personave të Riatdhesuar të Ministrisë së Brendshme Republikës së Kosovës.